



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5554/Prot.

Tiranë, më 11.09. 2025

UDHËZIM

Nr. 24, datë 11.09. 2025

PËR

NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 1.12.2023, "PËR PILOTIMIN E SKEMËS SË MËSUESIT NË DISPOZICION DHE DETYRAVE TË TIJ NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 57, të neneve 26 dhe 60, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

UDHËZOJ:

1. Në pikën 1, të kreut I, të udhëzimit nr. 25, datë 1.12.2023, "Për pilotimin e skemës së mësuesit në dispozicion dhe detyrave të tij në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar", i ndryshuar, togfjalëshi "...për vitin shkollor 2024–2025.", zëvendësohet me togfjalëshin "...për vitin shkollor 2025–2026."
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR

ORJANA OSMANI

